


A janë shkollat të afta të arrijnë qëllimin?

Një vërejtje politikash që eksploron deri në ç'skallë Maqedonia e Veriut po përfiton maksimumin nga burimet arsimore të vendit.

PËRMBLEDHJA

Maqedonia e Veriut po përballet me një krizë në mësim, me performancën nxënësve poshtë mesatares së Ballkanit Perëndimor, BE-së dhe OBZHE-së. Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë arritur të kenë rezultate më të mira në mësim me nivele pak më të larta të shpenzimeve në arsim. Ndryshimet e mëdha demografike, përfshirë rënien e natalitetit, shpërnguljen dhe rritjen e urbanizimit pa përshtatje të mëdha të rrjetit të shkollave fillore, kanë rezultuar në disa shkolla të kenë staf dhe hapësira të pashfrytëzara. Në kontrast me këtë, në disa shkolla ka mbingarkesë dhe mungesë mësuesish, si rrjedhim, ato duhet të organizojnë klasat me me dy a tre turne – që me gjasa ndikon te rezultatet e mësimi. Ndryshime të tilla kanë sjellë ndarjen joefikase dhe jo të barabartë të burimeve. Momentalisht, 87% e shpenzimeve të shkollave fillore janë për rrogat e stafit, duke lënë kështu fonde të pamjaftueshme për investime kapitale, për rinovim dhe mirëmbajtje të godinave dhe për investime të stafi punonjës për zhvillimin e tij profesional. Kjo po ndodh në kontekst kur ndarjet e përgjithshme buxhetore për arsimin si pjesë e PVB-së dhe shpenzimet totale kanë rënë. [Kjo përmbledhje ofron dëshmi dhe rekomandime për politikën për rritjen urgjente të efikasitetit dhe efektivitetit të rrjetit të shkollave, duke siguruar barazi në aksesin te shkollat.](#)

Performanca Arsimore Ndërkombëtare dhe Rajonale sipas PISA-s 2018



KONTEKSTI

Aspiratat e Maqedonisë së Veriut për të përmirësuar kompetivitetin ekonomik dhe për të përshpejtuar integrimin e vendit në Bashkimin Evropian janë çelësi për të arritur më shumë siguri, fleksibilitet, qëndrueshmëri dhe të ardhme të begatë për qytetarët e saj. Arritja e këtyre qëllimeve varet kryesisht nga ndërtimi i një forcë pune shumë të kualifikuar dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor. Megjithatë, sipas indeksit të Bankës Botërore, [Human Capital Index \(2020\)](#) i cili vlerëson produktivitetin e gjeneratës së ardhshme të fuqisë punëtore krahasuar me një pikë referimi të arsimit të kompletuar dhe të shëndetit të plotë – një fëmijë i lindur në Maqedoninë e Veriut sot do të jetë 56 për qind produktiv kur të rritet, aq sa do të ishte nëse mbaron shkollimin


dhe gëzon shëndet të plotë. Kjo është shkallë më e ulët në Evropë dhe më e ulët sesa mesatarja e vendeve me të ardhura të mesme të larta. Arsimi me cilësi të lartë dhe të barabartë është një nga fushat më të rëndësishme për të krijuar mundësi të reja dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës për gjeneratat e sotme dhe të ardhshme. Kjo çel pyetjen nëse shkollat janë të përshtatshme të sigurojnë zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik dhe të përmirësojnë mirëqënien e qytetarëve të vendit.

Edhe para pandemisë COVID-19 Maqedonia e Veriut përballej me një krizë në mësim. [Programi PISA \(Programme for International Student Assessment \(PISA\)\)](#)ⁱ i fundit tregoi se performanca e vendit ishte nën mesataren e Ballkanit Perëndimor, BE-së dhe OBZHE-së. Ndërkohë që pati përmirësime në performancën e nxënësve krahasuar me vitet e kaluara, më shumë se gjysma e pesëmbëdhjetëvjeçarëve nuk arrijnë të përmbushin nivelet bazike të leximit dhe matematikës. Për më tepër, performanca arsimore në Maqedoninë e Veriut duket se riprodhon pabarazi ekzistuese, me studentë dhe vajza me avantazhe socio-ekonomike që performojnë më mirë se djemtë dhe studentë të pafavorizuar.ⁱⁱ

Pas 11 viteve në shkollë, fëmija mesatar në Maqedoninë e Veriut ka rezultate arsimore të barabarta me 7.3 vjet mësim. Ky është rezultati më i keq në Evropë. Me fjalë të tjera, ata ndjekin shkollën, por janë duke humbur 3.7 vjet të nxënies realeⁱⁱⁱ.

. iv

Vitet reale të nxënies së fëmijëve



Pesëdhjetë e katër javë mbyllje shkollash pa mësimin në prezencë dhe ndërperje të tjera të mësimin gjatë pandemisë e përkeqësuan më tej krizën e mësimin. Banka Botërore vlerëson se humbjet e mësimin të shkaktuara nga pandemia mund të jenë nga 6 deri në 10 pikë për mesataren e pikëve të PISA-s për leximin (393 në 2018). Tani më shumë se kurrë vendi ka nevojë t'i krijojë shkollat, të revitalizojë mësimin dhe të ringjallë empatinë e komuniteteve shkollore ashtu që çdo fëmijë – pa marrë parasysh ku jeton ose në është i pasur apo i varfër – të marrë të mësim me të njëjën cilësi.

Në vitet e fundit, nisur nga rekomandimet e [Rishikimit të Evaluimit dhe Vlerësimit të Arsimit të OBZHE-së](#), të mbështetur nga UNICEF-i, vendi ka filluar reforma në arsim, ashtu që fëmijët të jenë në gjendje të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Reforma vendos në qendër të saj rezultatet e mësimin të fëmijët dhe fokusohet në përmirësimin e vlerësimit të nxënësit; mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve të mësuesit dhe zhvillimin e karrierës; vendosjen e standardeve kombëtare; përmirësimin e qasjes në cilësinë e materialeve dhe mjeteve mësimore; digjitalizimin; investimin në infrastrukturën shkollore përfshirë pajisjet për të mbështetur zhvillimin e aftësive praktike dhe trajnimin vokacional.

Ndërkohë që këto përpjekje premtjnë të kontribuojnë në përmirësimin e rezultateve të nxënies së nxënësve, impakti që ata do të kenë do të varet gjithashtu nga shpërndarja me të cilën resurset arsimore (infrastruktura, burimet njerëzore dhe financiare) shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe të barabartë, në mënyrë që çdo fëmijë në vend të ketë qasje në arsim cilësor dhe të barabartë.

PAMJA MOMENTALE E PËRDORIMIT TË BURIMEVE

Shkollat janë në zemër të sistemeve të arsimit. Resurset që kanë shkollat për të ofruar mësimdhënie dhe mundësi mësimi përcaktojnë në masë të madhe sa efektive do të jenë ato në përmbushjen e premtimeve të reformave arsimore për të përmirësuar rezultatet e mësimin te nxënësve.


Sipas [Studimit për Arsimin në Ballkanin Perëndimor](#),^v vendi po pëson ndryshim gjithëpërfshirës demografik, përfshirë uljen e numrit të lindjeve, shpërnguljen dhe rritjen e urbanizimit. Kjo rezulton me disa shkolla të mbipopulluara dhe mospërdorim të mjaftueshëm të shkollave në zonat e tjera që ndonjëherë mund të kenë më shumë staf sesa nxënës. Shkollat që menaxhohen, mirëmbahen dhe plotësohen me staf me shkallë të ndryshme shërbimesh, shpien në një gamë të gjerë përvojash dhe rezultatesh të nxënies. Në këtë mënyrë ka alokime joefikase dhe të pabarabarta të resurseve mes shkollave.

- **Pamja momentale e përdorimit të burimeve – infrastruktura fizike**

Rrjeti i shkollave fillore të Maqedonisë së Veriut ka mbi 1 000 shkolla, 363 shkolla qendrore dhe 637 shkolla periferike. Shkollat periferike që menaxhohen nga administrata e shkollave qendrore synojnë të sjellin edukim në zona më të largëta urbane ose komunitete rurale. Ato përbëjnë dy të tretat e rrjetit shkollor, por shërbejnë vetëm për 7% të nxënësve.


93% e nxënësve (171,000) ndjekin shkollimin në 363 shkolla qendrore dhe 7% e nxënësve (më pak se 12,800) e ndjekin shkollën në 637 shkolla periferike.^{vi}

Rrjeti shkollor fillor



Akomodimi i një numri të madh studentësh në një numër relativisht të vogël shkollash qendrore ka sjellë mbipopullimin e disa shkollave qendrore. Kjo kërkon që menaxhimi i shkollës të fusë mësimin me turne. **Dy të tretat e shkollave qendrore (240) e mbajnë më dy turne dhe katër shkolla duhet të shtrihen në dy-tre turne (ose mesturne).**^{vii}


Si e organizojnë mësimin 363 shkolla qendrore



Situata në të cilën pjesa më e madhe e shkollave ofron mësim me dy turne është një nga arsyet pse nxënësit e Maqedonisë së Veriut kanë më pak orë mësimi. Kjo, nga ana tjetër, kufizon gjerësinë dhe thellësinë e mësimin dhe mundësinë që studentët të kenë lëndë shtesë ose orë shtesë.

Në moshën 6- vjeçare, nxënësit e klasës së parë në Maqedoninë e Veriut kanë një ndër nivelet më të ulëta të kohës së synuar të mësimin (552 orë) në mesin e shtatëdhjetë e nëntë vendeve që bëjnë pjesë në PISA. Në moshën 14-vjeçare, ata do të kenë pasur rreth 900 orë mësimi mesatarisht më pak se nxënësit e vendeve të OBZHE-së.^{viii}

Orët totale të mësimi mes moshës 6 dhe 14




Për të adresuar sfidën, reforma e arsimit fillor synon të rrisë orët e mësimi. Megjithatë, rritja e tillë do të kërkojë që shkollat të krijojnë kushte të operojnë në një turn të vetëm.

Reforma parashikon gjithashtu rishikimin dhe futjen e standardeve të reja të arsimit, përfshirë standardet për pajisjet shkollore dhe të infrastrukturës, po ashtu dhe qasjen dhe sigurinë. Përmbushja e këtyre standardeve do të kërkojë rregullimin e infrastrukturës fizike – qoftë nëpërmjet investimeve, ose përmes ripërdorimit të godinave të pashfrytëzuara sa duhet.

• **Pamja momentale e përdorimit të burimeve – burimet njerëzore**

Numri i mësuesve në Maqedoninë Veriut vazhdon të rritet, duke iu shërbyer më pak nxënësve në klasa që tkurren.


Numri i nxënësve kundrejt mësuesve



Në dy dekadat e fundit përpjesëtimi nxënës-mësues është zvogëluar nga 18 nxënës për

mësues në 10 nxënës për mësues. Duke pasur parasysh stafin që nuk jep mësim, disa shkolla kanë më shumë staf se nxënës. Të dhënat nga rezultatet e PISA-s për Ballkanin Perëndimor(X) sygjerojnë se as shkollat më të vogla e as përpjesëtimet e vogla nxënës -mësues nuk ndikojnë te përmirësimi i rezultateve mësimore. Megjithatë, përpjesëtimet e ulëta nxënës -mësues ndikojnë negativisht tek efikasiteti i rrjetit shkollor.

Nxënës për mësues




Në vendet e zhvilluara të OBZHE-së dhe BE-së, përpjesëtimi mesatar nxënës-mësues është 15 dhe 13.5. Madje në vendet fqinje si Serbia(xi) dhe Mali i Zi(xii), vlerat janë më të larta, pra 14.5 dhe 15. **Megjithatë, në Maqedoninë e Veriut më shumë se gjysma e komunave kanë një numër mesatar nxënësish për mësues mes 5 dhe 10.** Përveç kësaj, në Maqedoni shkollat me përpjesëtimin më të ulët nxënës-mësues kanë më pak se pesë nxënës për mësues.(xiii)

Përpjesëtimi nxënës-mësues	Numri i komunave
2019/2020	
0-5	10
6-10	43
11-15	24
16-20	3


Kur kemi parasysh madhësinë e klasave, Ligji i Arsimit Fillor thotë që çdo klasë duhet të ketë të paktën 20 nxënës. **Në fakt vetëm 18 (23%) komuna përmbushin këtë detyrim dhe në**

shumicën e komunave klasat kanë një madhësi mesatare mes 11 dhe 15 nxënësish. Në disa shkolla, sidomos ato në zonat e largëta, mund të justifikohet që të ketë klasa me përmasa të vogla, për t'u siguruar se të gjithë nxënësit gëzojnë të drejtën e arsimit në komunitetin e tyre. Marrësit e vendimeve duhet të gjejnë balancimin të mirë mes efikasitetit dhe barazisë.



Për shkak të ndërrimeve demografike në disa komuna ka mungesë mësuesish, ndërsa në disa të tjera burimet njerëzore janë në papërdorura mjaftueshëm. Përveç kësaj, rreth 9% e mësuesve po i afrohen pensionimit.

Tërësia e mësuesve dhe mosha e tyre




Një analizë më e hollësishme në nivel komunal e strukturës së totalit të mësuesve nënvizon mungesën shqetësuese të mësuesve. Për shembull: ka mungesë mësuesish klasorë të kualifikuar krahasuar me mësuesit e lëndëve. Madje edhe mes mësuesve të

lëndës ka mungesë mësuesish të kualifikuar matematike, fizike dhe kimie, krahasuar me mësuesit e shkencave sociale. Shkollat që mbajnë mësim në gjuhë tjetër përveç maqedonishtes po përballen me sfida shtesë për të përshtatur fuqinë punëtore.

Përveç kësaj, projeksionet tregojnë se numri total i nxënësve do të vazhdojë të bjerë, dhe ndonëse rrjeti i shkollave mund të ruajë baraspeshën përmes pensionimit gradual të mësuesve, do të duhet një riskstrukturim i burimeve për të adresuar pabarazitë në nivel komune.


Numri i projektuar total i nxënësve



3. Pamja momentale mbi përdorimin e burimeve – burimet financiare

Vendi harxhon për arsim më pak se mesatarja ndërkombëtare dhe kjo përqindje ka qenë në rënie. Me 3.7-përqindëshin e PVB-së në 2018(xiv), harxhimet publike për arsim në Maqedoninë e Veriut janë më të ulëta në Ballkanin Perëndimor(xv) dhe shumë më të ulëta se mesatarja e vendeve të OBZHE-së prej 5.2 përqind e PVB-së(xvi)ose mesatarja EU-27 prej 4.9 përqind(xvii). **Mes viteve 2011 dhe 2016, harxhimet publike për arsim në Maqedoninë e Veriut si përqindje e PVB-së ranë nga 4.6% në 3.7%. Pjesa e harxhimeve totale të qeverisë të ndara për arsim ranë gjithashtu nga 13.3% në 11.6%.(xviii)**

Financimi i edukimit (të gjitha nivelet) si përqindje e PVB-së (viti)




Sipas OBZHE-së(xix), një analizë krahasuese e harxhimeve kumulative për nxënës vis-à-vis rezultateve mësimore të nxënësve (performanca në testin e leximit PISA) sygjeron se, ndonëse rritja e financimit do të jetë e rëndësishme për përmirësimin e rezultateve të arsimit, ka hapësirë që Maqedonia e Veriut të arrijë rezultate më të mira me burimet që investon tashmë. **Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë arritur shkallë më të larta pjesëmarrjeje dhe rezultate mësimore më të mira me nivele harxhimesh pak më të larta në arsim. Kjo flet për mundësitë për të përmirësuar efikasitetin e harxhimeve në arsim.**

Qeveria qendrore ndan buxhet për komunat për të mbuluar shpenzimet operationale të shkollave. Formula aktuale e financimit të shkollave fillore përbëhet nga një shumë për çdo komunë, plus një shumë standarde për çdo nxënës, duke iu përshtatur dendësisë së popullsisë, numrit të nxënësve në klasët e lëndëve(xx) dhe numrit të nxënësve me nevoja të veçanta. Formula jep një sasi më të madhe për nxënës për komunat e vogla, për të kompensuar harxhimet e larta që vijnë nga mungesa e ekonomisë së shkallës. Struktura e tillë e formulës nuk krijon stimule për të përmirësuar efikasitetin e shpenzimeve ose për të arritur ekonimotë e shkallës përmes konsolidimit të shkollave. Kjo formulë në fakt favorizon shkollat fillore të vogla ndoshta për shkak të faktit se rreth 44 përqind e shkollave fillore kanë më pak se 100 nxënës. Megjithatë, problemet dalin kur ka fonde të pamjaftueshme për të mirëmbajtur shumë shkolla të vogla në gjendje të mirë, të qasshme, ose në gjendje të paguajnë stafin që duhet për çdo shkollë. Përveç kësaj, formula aktuale e financimit të shkollave

gjithashtu synon të mbrojë shkollat në komunat me popullsi me dendësi të ulët. Megjithatë kjo sjell në zvogëlimin e madhësive të klasave, që janë të shtrenjta për mbajtje. Pavarësisht prej formulës zyrtare të financimit, e përshkruar më sipër, në praktikë financimi aktual që marrin komunat për shkollat fillore përcaktohet nga alokimet e vitit të kaluar dhe nga rritja e dakorduar e rrogave(xxi). Në këtë mënyrë, komunat me rënie demografike kanë mungesa stimulimesh financiare që të mund të përshtatin stafin e shkollës, të konsolidojnë shkollat dhe të përmbushin standardet arsimore dhe infrastrukurore.

84% e transfereve të Qeverisë për arsimin fillore të komunave shkojnë për të mbuluar harxhimet për rrogat e mësuesve dhe stafit profesional. Rritja e rrogave në vitin 2021 e çoi këtë në 87%, dhe me rritjen e dakorduar të mëtejshme në vitin 2022, vlera mund të shkojë në 91%. Kjo do të përkeqësojë mungesën e fondeve për investime kapitale, për harxhime rrjedhëse për rinovim dhe mirëmbajtje të godinave, për investimin profesional të stafi dhe për harxhime të tjera operative – duke krijuar kështu një situatë financiare të papërmbajtshme.

Shpenzimet për arsimin fillor 2010-2020



Analiza e harxhimeve për nxënës nga shkollat rurale dhe urbane thekson mospërputhje të konsiderueshme. **Ndryshimet e harxhimeve mes shkollave rurale bien në shumë në sy- komunat me më shumë harxhime për nxënës harxhojnë pothuajse 15 herë më shumë krahasuar me komunat me harxhime më të ulëta për nxënës.**


fjalë të tjera - bëhet i aftë për qëllimin dhe është i qëndrueshëm.

KONSIDERATAT E POLITIKAVE

Qeveria e Maqedonisë së Veriut është e vetëdijshme për sfidat e sipërpërmendura dhe është zotuar të përmirësojë efikasitetin dhe efektshmërinë e financimit të shkollave fillore duke studiuar opsionet për optimizimin e rrjetit të shkollave fillore dhe për të rishikuar formulën e financimit. Politikëbërësit mund të konsiderojnë si vijon:

- **Përmirësimi i rezultateve mësimore të nxënësve do të kishte dobi nga rritja e fondeve për arsimin fillor dhe përdorim më efikas.** Kjo do të rriste jo vetëm cilësinë e arsimit, por do t'i afronte harxhimet publike të vendit me nivelet e BE-së. Optimizimi i shkollave fillore do të shtrojë nevojën për rritjen e investimeve publike në arsim, përfshirë përshtatjen e infrastrukturës dhe investimin në burimet njerëzore.
- **Optimizimi i shkollave duhet të sigurojë që rrjeti i shkollave i përshtatet realitetit demografik lokal, me rregullimet e nevojshme për barazi.** Duhet të identifikojë mënyrat optimale për të përmirësuar alokimin e kufizuar të burimeve, në mënyrë që të gjitha shkollat fillore mund të jenë në gjendje të ofrojnë arsim sipas standardeve arsimore dhe infrastrukture kombëtare dhe legjislacionit kombëtar. Optimizimi duhet të: krijojë një sistem arsimor fillor të barabartë, të krijojë kushte të barabarta në të gjitha shkollat, të mundësojë shkollat që të ofrojnë më shumë orë mësimore dhe të sigurojë alokim efikas të burimeve.
- **Planet komunale të optimizimit duhet të bazohen në një indeks të unifikuar i cili ka parasysh tri dimensione:** 1) Fiskal–përfshirë

Ndryshimet sipas harxhimeve për nxënës (MKD)



Si përfundim, formula aktuale e financimit të shkollave fillore krijon një situatë financiare të paqëndrueshme dhe shpie në shpërndarje shumë të pabarabartë të burimeve.

Pamja e momentit e burimeve infrastrukturore, njerëzore dhe financiare e shkollave fillore flet për nevojën urgjente për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e ndarjes së burimeve në Maqedoninë e Veriut, sidomos për të përforcuar përpjekjet për të optimizuar rrjetin e shkollave dhe për të rishikuar financimin.

ÇMIMI I MOSVEPRIMIT

Pa veprim urgjent për të optimizuar rrjetin e shkollave fillore dhe për të rishikuar formulën e financimit, infrastruktura e shkollave do të ngelet joadekuate për të përmbushur standardet arsimore komëbëtare. Përbërja dhe shpërndarja joadekuate e stafit të shkollave do të vazhdojë të mos prodhojë shkathhtësitë dhe njohuritë e studentëve që t'iu përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe nevojave për rritjen e produktivitetit të fuqisë punëtore. Në kontekstin e një thellimi të krizës financiare, do të vijë koha kur rrjeti aktual i shkollave dhe nivelet e financimit nuk do të jenë më të mundshme, prandaj motivi për optimizimin e rrjetit të shkollave, në fakt, është një tentativë për të siguruar që sistemi arsimor ofron arsim të cilësisë së lartë dhe të barabartë. Me

rrogat dhe harxhimet e tjera operative; 2) Infrastruktural-përfshirë nevojat për investim; dhe 3) Arsimor - madhësia dhe struktura e klasave, performanca arsimore dhe kapacitetet e mësuesve. Planet do të ofronin projekt për përshtatjen e kapaciteteve infrastrukturore dhe arsimore, përfshirë zgjerimin e rrjetit të shkollave në komunat ku ka nevojë të tillë, riorganizimin rrjetit të shkollave dhe klasave, dhe, mundësisht, në disa raste, ripërcaktimin e godinave të papërdorura për të plotësuar nevojat e tjera lokale. Kjo mund të përfshijë gjithashtu ritrajnimin dhe rikualifikimin e stafit mësimor për të adresuar mangësitë në strukturat e stafit dhe në alokim. Për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, mundësitë për avancim në karrierë duhet të krijohen përmes krijimit të posteve për mentorë dhe këshilltarë të mësimdhënies. Adresimi i burimeve njerëzore është akoma më urgjent duke pasur parasysh rritjen e stafit të shkollës dhe pakësimin e fondit të nxënësve.

- **Optimizimi duhet të bëhet paralelisht me rishikimin e formulës së financimit të shkollave fillore**, për të përmirësuar efikasitetin, për të përmirësuar performancën, për të siguruar që alokimet janë bazuar në kritere objektive dhe janë të drejta. Rishikimi duhet të bazohet te harxhimet për nxënës, ashtu që të përmbushen standardet arsimore në më shumë kontekste (p.sh.: urbane/rurale, gjithashtu duke pasur parasysh ekonominë e shkollës nga të cilat benefit kanë shkollat e mëdha). Kjo do të mundësojë mësimdhënie në godina adekuate dhe të arritshme, të cilat mirëmbahen dhe pajisen siç duhet. Gjithashtu do të lejojë shkollat të angazhojnë numër dhe përbërje optimale të stafit mësimor, profesional dhe teknik.
- **Duhet të përfshihet një komponentë për të mbështetur zhvillimin profesional rrjedhës të mësuesve**, për të stimuluar aplikimin e

praktikave mësimore inovative, për të mbështetur kalimin e stafit mësimor të zgjedhur në role të reja bashkëpunëtorësh profesionalë. Formula duhet të përfshijë një përqindje që rritet për shkollat, performancat e të cilave janë përmirësuar vit pas viti, në mënyrë që të stimulohet dhe të motivohet shkolla që të marrë rol aktiv në përmirësimin e rezultatave mësimore të nxënësve.

- **Formula e financimit duhet të sigurojë edhe barazi**, përfshirë inkuadrimin e alokimeve adekuate për: transportin e nxënësve që jetojnë larg shkollës, përfshirjen e fëmijëve me nevoja arsimore të veçanta, mësimin në gjuhët ebashkësive etnike më të vogla, qasjen e financuar në burimet arsimore online për nxënësit që vijnë nga amvisëri me pak të ardhura, inkuadrimin e programeve të ngrënies në shkollë për të luftuar varfërinë dhe për të adresuar kequshqimin. Duhet të krijohen vegla për shpërndarjen e drejtë të fondeve për secilën shkollë të cilat komunat i marrin nga qeveria – bazuar te numri i nxënësve dhe harxhimet për çdo nxënës. Përveç kësaj, krijimi i mjeteve për të siguruar se fondet e marra për qëllime të shenjuara, si qasja e nxënësve me kufizime ose sigurimi i mjeteve digjitale për nxënësit që kanë nevojë– në fakt përdoret për të përmirësuar kushtet për këto grupe të ndjeshme. Gjithashtu, autoritetet duhet të vendosin parime për të siguruar barazi për fëmijët që jetojnë në zona të largëta. Kjo mund të përfshijë, për shembull, angazhimin që fëmijët nën klasën e katërt të mund të mësojnë në komunitetin e tyre lokal, ose distancën maksimale udhëtimi të kufizuar për fëmijët për të mbërritur deri te shkolla.
- **Rishikimi i formulës duhet të faktorizojë një komponentë kalimtare përshtatjeje**, e cila do të kufizojë ndryshimet vjetore të financimit për shkollë. Një opsion është përcaktimi i një

periudhë kalimtare 5-vjeçare, gjatë së cilës financimi nuk do të ndryshojë më shumë se $\pm 10\%$ në vit, për të shmangur goditjet e mëdha.

- **Procesi duhet të jetë pjesëmarrës për të siguruar konsiderimin e të gjitha perspektivave.** Duhet të zhvillohen plane individuale dhe të zbatohen në koordinim të ngushtë me autoritetet komunale, stafin e shkollës, prindërit, nxënësit dhe faktorët e tjerë lokalë.
- **Procesi i optimizimit duhet të shkojë dorë për dorë me rinovimin e standardeve kombëtare për infrastrukturën e shkollave, furnizimin me pajisje dhe mjete të tjera mësimore.** Ndonëse vendi ka urdhërese për standardet arsimore, po ato standarde janë të vjetra dhe duhet një rishikim për t'i rinovuar në përputhje me kornizat ndërkombëtare relevante dhe trendet e reja në arsim, siç janë digjitalizimi dhe arsimiti inkluziv.
- Krijimi i politikave të bazuara në dëshmi kërkon monitorim më të mirë të sistemit të vlerësimit. **Kapacitetet dhe sistemet për mbledhjen e të dhënave dhe analizat në nivel lokal dhe kombëtar duhet të forcohen.** Shkollat komunale dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të mbledhin, të raportojnë dhe të analizojnë të dhënat financiare, arsimore dhe të dhënat e tjera në mënyrë të harmonizuar.

MBËSHTETJA E UNICEFIT

Në bashkëpunim me Bankën Botërore, UNICEF-i ka mbështetur Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për të përmirësuar përshtatshmërinë, efikasitetin, efektivitetin dhe shpenzimet publike të barabarta në arsimin fillor dhe të mesëm, duke ndihmuar për të riparuar transferimet e qeverisë për komunat që financojnë shkollat. Buxheti i vitit 2022, i përgatitur duke përdorur formulën e rishikuar të financimit, parashikon rritjen e transfertave në shkollat fillore të komunave me 8 milionë dollarë. Falë natyrës globale të ndryshimit dhe të alokimit për nxënësit për shkollat që të plotësojnë standardet arsimore, UNICEF-i do të kontribuojë për një qasje dhe përfshirje të fëmijëve me lëndueshëm, përfshirë edhe ata me kufizime, minoritetet etnike dhe fëmijët nga familje të varfra. Formula e re e financimit ofron financa të mjaftueshme për mirëmbajtje adekuate, investime të nevojshme për pajisje dhe vegla ndihmëse, për trajnim profesional dhe për zhvillimin e stafit të shkollës, si dhe rritje të numrit të bashkëpunëtorëve profesionalë. Nëse Qeveria e aprovon formalisht formulën e re dhe vazhdon ta përdorë atë, deri në vitin 2026 fondet e transferuara të komuna për arsimin fillor është projektuar të rriten me 35%, dhe kjo do të ishte një hap madhor përpara për t'i afruar shpenzimet publike të vendit për arsimin më afër niveleve të BE-së dhe OBEZH-së.

Gjithashtu, UNICEF-i ka mbështetur zhvillimin i një indeksi inovativ për optimizimin e rrjetit të shkollave fillore, burimeve njerëzore dhe burimeve të tjera, si dhe draft-planet e optimizimit të 80 shkollave komunale. Indeksi i optimizimit të shkollave mat hullinë që ndan çdo shkollë fillore dhe çdo komunë nga standardet arsimore dhe infrastrukturore, si dhe tenton të mbyllë hullinë mes shpenzimeve rrjedhëse për nxënësit dhe shpenzimeve që nevojiten për të përmbushur standardet. Bazuar te vlera e indeksit, UNICEF-i mbështet përgatitjen e një plani të hollësishëm për çdo komunë që të

përshtatë kapacitetet infrastrukturore dhe arsimore, ndërkohë që efikasiteti financiar do të përmirësohet duke përdorur formulën e re të financimit të shkollave. Planet e optimizimit identifikojnë mënyra për të përmirësuar ndarjen e burimeve të kufizuara, të cilat sigurojnë që të gjitha shkollat fillore mundësojnë mësim në përputhje me standardet, ligjet dhe konceptet arsimore kombëtare. Implementimi i këtyre planeve do të zhvillojë një sistem të barabartë për arsimin fillor; do të kontribuojë për kushte mësimi të barabartë dhe do të sigurojë ndarjet efikase të burimeve. Këto ndryshime do të jenë instrumente për adresimin e ndashmërisë digjitale dhe pabarazive të tjera, përfshirë ato sipas gjinisë, etnisë dhe kufizimeve.

[en - e bazuar te të dhënat.](#)

ENDNOTE REFERENCES

ⁱ World Bank (2020), Human Capital Project. Достапно на: <https://www.worldbank.org/en/publication/human-capital>

ⁱⁱ European Commission, OECD, UNICEF (2020) Education in the Western Balkans. Достапно на: https://www.oecd-ilibrary.org/education/education-in-the-western-balkans_764847ff-en

ⁱⁱⁱ World Bank (2020), *Human Capital Project*. Available at: <https://www.worldbank.org/en/publication/human-capital>

^{iv} World Bank (2020), *Human Capital Project*. Available at: <https://www.worldbank.org/en/publication/human-capital>

^v European Commission, OECD, UNICEF (2020) *Education in the Western Balkans*. Достапно на: https://www.oecd-ilibrary.org/education/education-in-the-western-balkans_764847ff-en

^{vi} UNICEF (2021) Unpublished Analysis

^{vii} UNICEF (2021) Unpublished Analysis

^{viii} OECD (2019) *Reviews of Evaluation and Assessment in Education: North Macedonia*. Достапно на: <http://www.oecd.org/education/oecd-reviews-of-evaluation-and-assessment-in-education-north-macedonia-079fe34c-en.htm>